



UNIVERSITETI "HAXHI ZEQA"
FAKULTETI AGROBIZNESIT

Programi: Tekologjia e Prodhimit Bimor (BSc)

Emërtimi i programit të studimit:	Tekologjia e Prodhimit Bimor
Niveli i kualifikimit sipas KKK:	Arsimi i lartë – Cikli i parë i Bolonjës (Bachelor) BSc. Niveli 6 sipas KKK
Numri ECTS kredive:	180
Grada akademike (kualifikimi i fituar):	Bachelor i shkencës në Teknologji ushqimore (BSc)
Kohëzgjatja e programit të studimit:	Tre vite / 6 semestra
Qëllimi dhe objektivat e programit të studimit:	<p>Qëllimi kryesor i programit është të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përgatisë profesionistë kompetentë në fushën e teknologjisë së prodhimit bimor, të aftë të kontribuojnë në zhvillimin e sektorit bujqësor në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar; • Sigurojë arsim cilësor dhe praktik që i pajis studentët me njohuri teorike dhe shkathtësi praktike në prodhimin dhe përpunimin e kulturave bimore; • Nxisë zbatimin e parimeve të qëndrueshmërisë në prodhimin bimor për të përballuar sfida globale si ndryshimet klimatike, pasiguria ushqimore dhe ruajtja e biodiversitetit; • Kontribuojë në zhvillimin ekonomik të rajonit të Pejës dhe të vendit në përgjithësi përmes avancimit të teknologjive në bujqësi. <p>Objektivat kryesore të programit:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Formimi profesional i studentëve për të planifikuar, organizuar dhe menaxhuar procese të prodhimit bimor duke përdorur teknologji bashkëkohore. • Integrimi i njohurive teorike me praktikat profesionale, duke siguruar përgatitje të balancuar për sfidat reale në sektorin bujqësor. • Përdorimi i metodave të qëndrueshme të prodhimit, me fokus në mbrojtjen e mjedisit dhe përdorimin racional të resurseve natyrore. • Zhvillimi i aftësive kërkimore dhe inovative për të kontribuar në modernizimin e bujqësisë dhe rritjen e produktivitetit.

	<ul style="list-style-type: none"> • Përputhja me nevojat e tregut të punës, duke ndërtuar kompetenca që janë të kërkuara në sektorin bujqësor publik dhe privat. • Promovimi i ndërdisiplinaritetit në fushat e mjedisit, ekonomisë, politikave bujqësore dhe inovacionit teknologjik. • Përgatitja e kuadrove për lidërsip në sektorin bujqësor, me aftësi për të drejtuar iniciativa zhvillimore dhe për të kontribuar në politikat e prodhimit ushqimor. • Nxitja e bashkëpunimit me sektorin privat dhe publik, përmes praktikave profesionale dhe projekteve kërkimore. • Mbështetja e zhvillimit të qëndrueshëm rural, duke kontribuar në mirëqenien e komuniteteve bujqësore dhe ruajtjen e resurseve natyrore.
<p>Rezultatet e pritshme të të nxënit:</p>	<p>Studenti i programit Teknologji e Prodhimit Bimor pas përfundimit të programit të studimit do të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Poseidon njohuri teorike dhe praktike në prodhimin e ushqimeve bimore: Aplikon metodat më të avancuara dhe teknologjitë e fundit, duke përfshirë teknologji bashkëkohore për mbjellje, plehërim, monitorim dhe trajtim të bimëve. • Zotëron njohje në bazat e shkencës së bimëve: Përfshirë njohuri të thella në botanikë, fiziologji, biokimi, gjenetikë dhe ekologji. • Poseidon aftësi për përdorim të aparaturave laboratorike: Për analizat fiziko-kimike dhe pedologjike, si dhe për hulumtime fushore për kulturat bujqësore. • Poseidon aftësi hulumtuëse-shkencore: Kryen hulumtime të pavarura dhe aplikojnë metodologji shkencore në bujqësi. • Menaxhon fermat dhe projektet bujqësore: Duke fituar njohuri në ekonomi dhe menaxhim të prodhimeve bujqësore. • Ka njohuri për mbrojtjen e bimëve dhe bujqësinë organike: Përvetëson teknikat e mbrojtjes së bimëve kundër patogjenëve, insekteve dhe barojave të këqija si dhe aplikojnë parimet dhe praktikatat e bujqësisë organike. • Planifikon dhe menaxhon mbjelljet: Kujdeset dhe vjel kulturat bujqësore duke rritur rendimentin dhe cilësinë e produkteve. • Kompetent për prodhim dhe konsulent i pavarur: Në fushën e prodhimit të ushqimeve bimore, duke përdorur praktika të qëndrueshme dhe inovative. • Punon në mënyrë efektive në ekipe dhe komunikon qartë: Me menaxherët, stafin teknik dhe

	<p>institucionet përkatëse, duke monitoruar dhe dokumentuar proceset agroteknike dhe cilësinë e prodhimeve.</p>
<p>Procedurat e mësimdhënies:</p>	<p>1. Qasja pedagogjike</p> <ul style="list-style-type: none"> • Studenti në qendër të procesit mësimor — theksi vihet në pjesëmarrjen aktive të studentit, jo vetëm në dëgjimin pasiv të ligjëratave. • Mësimdhënia mbështetet në zhvillimin e kompetencave praktike dhe analitike, duke kombinuar pjesën teorike me atë praktike. • Zbatohen metoda bashkëkohore interaktive: diskutime, punë në grupe, raste studimore dhe simulime. <p>2. Llojet e aktiviteteve mësimore</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ligjëratat: prezantimi i koncepteve bazë dhe avancuara nga lënda përkatëse. • Ushtrimet praktike dhe laboratorike: zhvillohen në laboratorë të pajisur me teknologji ushqimore moderne. • Punë në terren dhe vizita profesionale: studentët angazhohen në institucione dhe biznese me të cilat fakulteti ka marrëveshje bashkëpunimi. • Seminare dhe diskutime: përdoren për të zhvilluar mendimin kritik dhe aftësitë prezantuese. • Punime të pavarura: ese, projekte dhe prezantime individuale apo në grupe. • Puna kërkimore: përfshihet në disa lëndë për të zhvilluar shkathtësi hulumtuese. <p>Raporti teori–praktikë në shumicën e lëndëve është 50 % teori dhe 50 % praktikë (në disa raste 60:40)</p> <p>3. Organizimi dhe orari</p> <ul style="list-style-type: none"> • Studimet zhvillohen sipas sistemit modular dhe janë të ndara në dy semestra në vitin akademik: <ul style="list-style-type: none"> ○ Semestri dimëror: 1 tetor – 15 janar ○ Semestri veror: 16 shkurt – 31 maj • Kalendarit akademik përmban orarin e ligjëratave, ushtrimeve, seminareve dhe afatet e provimeve. <p>4. Vlerësimi dhe monitorimi i mësimdhënies</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi i studentëve bëhet në mënyrë të kombinuar: pjesëmarrje aktive, teste, projekte, punë praktike dhe provime përfundimtare. • Çdo njësi akademike përgatit raporte periodike mbi vijueshmërinë dhe cilësinë e mësimdhënies. • Studentët ofrojnë feedback përmes pyetësorëve anonime, që shërbejnë për përmirësimin e metodave didaktike. • Zbatohen plane monitorimi për të siguruar cilësinë e ligjëratave dhe ushtrimeve. <p>5. Mbështetje për studentët gjatë mësimdhënies</p> <ul style="list-style-type: none"> • Konsultime individuale me profesorët dhe asistentët.

	<ul style="list-style-type: none"> • Tutorime dhe sesione mbështetëse për studentët me vështirësi akademike. • Përdorimi i platformave digjitale për shpërndarjen e materialeve mësimore dhe komunikim. • Përdorimi i praktikave mentorimi për integrimin më të mirë të pjesës teorike me praktikën.
<p>Procedurat dhe llojet e vlerësimit të përdorura (notimi i studentëve):</p>	<p>Sipas nenit 104, 105, 106 të Statutit të UHZ, vlerësimi përfundimtar i studentëve bëhet me anë të testimit me shkrim dhe me gojë.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pjesa e vlerësimit dhe notimit të studentëve varet nga lënda dhe kriteret e përdorura në mënyrë individuale nga mësimdhënësi i lëndës. • Studenti vlerësohet gjatë gjithë semestrit përmes testeve, punimeve seminareve, pjesëmarrjeve në projekte, konferenca shkencore, etj. • Metodatat e vlerësimit përcaktohen në syllabuse të secilës lëndë mësimore veç e veç në kuadër të programit, <p>Një shembull vlerësimi është si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pjesëmarrja aktive në mësim.....10 për qind • Detyrat, ushtrimet.....10 për qind • Testi i parë.....20 për qind • Testi i dytë.....20 për qind • Provimi përfundimtar.....40 për qind • Total 100% <p>Një shembull i kriterit të notimit është si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 0-50.99%(5) • 51-60.99%(6) • 61-70.99%(7) • 71-80.99%(8) • 81-90.99%(9) • 91-100%(10)
<p>Ndarja e lëndëve të programit sipas rëndësisë:</p>	
<p>a). Lëndët obligative:</p>	<p>Viti 1 – semestri I</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Kimi e përgjithshme dhe inorganike 2. Biologjia e përgjithshme 3. Matematikë 4. Agrometereologji me bazat e fizikës 5. Gjuhën angleze 6. Informatikë e aplikuar në bujqësi <p>Viti 1 – semestri II</p> <ol style="list-style-type: none"> 7. Bazat e prodhimit bimor 8. Pedologjia 9. Kimia Organike 10. Ekologjia Bujqësore 11. Botanikë e përgjithshme dhe sistematike <p>Viti 2 – semestri III</p> <ol style="list-style-type: none"> 12. Entomologjia 13. Biokimia 14. Teknologjia e drithërave 15. Të ushqyerit e bimëve 16. Mikrobiologji bujqësore <p>Viti 2 – semestri IV</p> <ol style="list-style-type: none"> 17. Fiziologjia e bimëve

	<p>18. Bazat e gjenetikes 19. Bazat e Perimtarisë 20. Bazat e Pemëtarisë 21. Ekonomia e prodhimeve bujqësore</p> <p>Viti 3 – semestri V</p> <p>22. Fitoteknia 23. Përmirësimi gjenetik i bimëve 24. Teknologjia për përpunimin e maltit 25. Fitopatologjia 26. Mekanizimi bujqësor</p> <p>Viti 3 – semestri VI</p> <p>27. Mbrojtja integrale 28. Bujqësia Organike 29. Metodologjia e hulumtimit 30. Punim Diplome</p>
<p>b) Lëndë zgjedhore:</p>	<p>Viti 1 – semestri II</p> <p>1. Barërat e këqija 2. Bimët foragjere</p> <p>Viti 2 – semestri III</p> <p>3. Faërat dhe prodhimi i findaneve 4. Ndermarrësia e gjelbër</p> <p>Viti 2 – semestri IV</p> <p>5. Bazat e vreshtarisë 6. Bazat e shkencës animale</p> <p>Viti 3 – semestri V</p> <p>7. Bimët aromatike dhe medicinale 8. Lavertaria speciale</p> <p>Viti 3 – semestri V</p> <p>9. Parimet dhe praktika e ujitjës 10. Teknologjia e pasvjeljes 11. Mjediset e mbrojtura dhe lulëtaria</p>
<p>Perspektiva e studentit – Mundësitë e punësimit pas diplomimit në Teknologjia e Prodhimit Bimor (BSc)</p>	<p>Programi Teknologjia e Prodhimit Bimor përgatit studentët me njohuri teorike dhe praktike në fushën e prodhimit, përmirësimit dhe menaxhimit të kulturave bujqësore, duke i aftësuar për të kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit agro-bimor. Studentët e këtij programi zhvillojnë aftësi për planifikim prodhimi, përdorim të teknologjive moderne bujqësore, menaxhim të resurseve natyrore dhe zbatim të standardeve të cilësisë në prodhim.</p> <p>Fushat kryesore të punësimit pas diplomimit përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ferma bujqësore dhe agrokorporata, në pozita si menaxher i prodhimit bimor, agronom teknik ose specialist për kultivimin e kulturave specifike; • Qendrat e këshillimit bujqësor dhe agjencitë e zhvillimit rural, duke ofruar asistencë teknike për fermerët në menaxhimin e tokës, ujitjes dhe fertilizimit;

	<ul style="list-style-type: none"> • Industrinë e farërave, plehrave dhe mbrojtjes së bimëve, në sektorin e zhvillimit dhe testimit të produkteve të reja bujqësore; • Institucionet publike dhe komunale, në pozita që lidhen me planifikimin bujqësor, kontrollin fitosanitar dhe politikatat e zhvillimit rural; • Qendrat e kërkimit shkencor dhe universitetet, në fushat e bioteknologjisë bimore, prodhimit organik dhe ruajtjes së biodiversitetit; • Organizatat joqeveritare dhe projektet ndërkombëtare, që fokusohen në zhvillimin e bujqësisë së qëndrueshme, inovacionin rural dhe sigurinë ushqimore; • Sipërmarrjen e pavarur bujqësore, përmes themelimit të fermave moderne, serrave, apo bizneseve të vogla të përpunimit dhe tregtimit të produkteve bimore. <p>Në përputhje me perceptimet e studentëve, programi Teknologjia e Prodhimit Bimor u jep të rinjve mundësinë të ndërthurin njohuritë shkencore me praktikën në terren, duke i përgatitur për një treg pune që kërkon inovacion, qëndrueshmëri dhe ekspertizë profesionale në bujqësinë moderne.</p>	
Kostoja e shpenzimeve		
Lloji i shpenzimit	Përshkrimi	Vlerë e përafërt (€/vit)
Librat dhe materialet mësimore	Librat, artikujt shkencorë, softuerë mësimor	100 – 300
Pajisjet laboratorike/fushore	Instrumente për matje mjedisore, material laboratorik	250 – 500
Transporti dhe udhëtimet	Udhëtime për vizita studimore, ekskursionet, praktika	100 – 300
Akomodimi dhe ushqimi	Shpenzime për qëndrim dhe ushqim gjatë praktikave apo projekteve në terren	500 – 750
Shpenzime të tjera personale	Shëndet, komunikim, internet, material shtesë	100 – 200